

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / РЕПУБЛИКА КООСОВО	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Nr. Protok. Org. Unit Nr. i Faqeve Rr. Stranica No. Pages	SP-02 - 09 -
Nr. i Prot. Prot. No. Datum Date	5306-e/25 01.09.25
PRISHTINË, A	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary


DATË/A:	12.08.2025
REFERENC-Ë:	25/5306/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Burimi-E" Sh.p.k.
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivit të MMPHI-së
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Transfer të Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën me Nr.Prot.25/5306/MMPHI të operatorit "Burimi-E" Sh.p.k. për transfer të Lejes Mjedisore nga "Burimi" Sh.p.k. për veprimtarinë: Fabrikë për prodhimin e asfaltit, Babush i Ri, Ferizaj.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure


Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 25/5306/MMPHI
Datë: 12.08.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 9 paragrafi 1 dhe nenin 18 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nenit 5 dhe 10 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore si dhe Vendimit për Leje Mjedisore Nr.21/4001/MMPHI dt.13.12.2022, nxjerr këtë:

VENDIM

Aprovohet kërkesa me Nr.Prot.25/5306/MMPHI, e Kompanisë "Burimi-E" Sh.p.k. Fabrikë për prodhimin e asfaltit, Babush i Ri, Ferizaj, për **Transfer të Lejes Mjedisore** nga Kompania "Burimi" Sh.p.k. Fabrikë për prodhimin e asfaltit, në ngastrën kadastrale nr.629/1 zona kadastrale, Babush i Ri, Ferizaj,



Arsyetim

Pas shqyrtimit të kërkesës me Nr.Prot.25/5306/MMPHI, të operatorit "Burimi-E" Sh.p.k. për transfer të Lejes Mjedisore, Nr.21/4001/MMPHI, të datës: 13.12.2022, MMPHI konstaton se operatori i plotëson kriteret e parapara për **transferimin e Lejes Mjedisore**, në përputhje me nenin 18 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Operatori ka bashkangjitur dokumentacionin:

- Vendimin e Lejes Mjedisore me Nr.21/4001/MMPHI, të datës:13.12.2022;
- Vendimin për transferim të Pëlqimit Mjedisor, me Nr.25/3465/ZSP/25, të datës: 09.06.2025;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit, në emër të kompanisë "Burimi" Sh.p.k. të lëshuar nga ARBK, me NUI 8111347055, të datës:07.06.2000;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit, në emër të kompanisë "Burimi-E" Sh.p.k. të lëshuar nga ARBK, me NUI 811233030, të datës:22.10.2008;
- Vendim për Validitet të Pëlqimit Mjedisor për kompaninë "Burimi" Sh.p.k. Nr.25/768/ZSP/25, të datës: 24.02.2025;

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, merr Vendim për aprovimin e kërkesës për **transferim të Lejes Mjedisore** me Nr.21/4001/MMPHI, të datës: 13.12.2022

Vendimi i transferimit të Lejes Mjedisore, vlen për periudhën e caktuar në Vendimin e Lejes Mjedisore ekzistuese.

Kompania trashëguese "Burimi-E" Sh.p.k. obligohet t'i përmbahet kushteve në Vendimin e Lejes Mjedisore me Nr.21/4001/MMPHI, të datës: 13.12.2022

Leja Mjedisore mund të revokohet, pezullohet apo shfuqizohet në çdo kohë në rast se:

- Pëlqimet apo lejet paraprake mbi bazën e të cilave është lëshuar leja mjedisore janë revokuar, pezulluar apo shfuqizuar;

- Vërtetohet se pala nuk i ka respektuar obligimet e përcaktuara në leje mjedisore;
- Nëse konstatohet se operatori, ka dhënë shënime të pa sakta dhe deklarime të rrejshme;
- Nëse operatori nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të këtij Udhëzimi Administrativ dhe legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi t'iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Ferizaj;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së